

Në pajtim me nenin 36 të Ligjit për qasje të lirë në informatat me karakter publik ("Gazeta zyrtare e R.M.V. nr. 101/2019) Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me seli në Bulevardin "Krstev Misirkov" nr. 8 në Shkup, telefon 02 3136-044, faks 02/3237-538, dhe e-mail: [info@vsrm.mk](mailto:info@vsrm.mk), përmes personit zyrtar për ndërmjetësim të informatave me karakter publik Mr. Snezhana Dimitrovska, përgatiti si vijon:

**RAPORT VJETOR**  
**(nga 1.01.2020 deri më 31.12.2020)**

**1. Të dhënat për personat zyrtar të caktuar për ndërmjetësim me informatat të poseduesit të informatave;**

Mr. Snezhana Dimitrovska, bashkëpunëtoresh e lartë gjyqësore  
e-mail : [snezana.dimitrovska@vsrm.mk](mailto:snezana.dimitrovska@vsrm.mk)

**2. Numri i kërkesave të pranuar;**

Në periudhën prej datës 01.01.2020 deri më datë 31.12.2020 në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë pranuar gjithsej dyzet e një (41) kërkesa për qasje në informata me karakter publik.

**3. Numri i kërkesave të përgjigjura pozitivisht;**

Numri i kërkesave të përgjigjura pozitivisht numëron tridhjetë e katër (34)

Dy (2) kërkesa janë ridërguar në gjykata të tjera në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 të Ligjit për qasje të lirë në informata me karakter publik;

Për pesë (5) kërkesa nga institucioni i sektorit joqeveritar për qasje në informata me karakter publik është vepruar në mënyrë që kërkuarësit i është dorëzuar njoftim me shkrim.

**4. Numri i kërkesave të refuzuara dhe të hedhura poshtë me theksimin e arsyeve për çdo kërkesë të refuzuar ose të hedhur poshtë;**

Kërkesa të refuzuara dhe të hedhura poshtë nuk ka.

**5. Numri i kërkesave jo të përgjigjura;**

Për të gjitha kërkesat për qasje në informata me karakter publik të pranuar në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë periudhës raportuese është vepruar dhe përgjigjur. Kërkesa jo të përgjigjura nuk ka.

**6. Numri i ankesave të parashtruara kundër vendimeve të shkallës së parë (aktvendimet e poseduesve të informatave, me përshkrim të vendimit, si dhe me**

## **theksimin e arsyeve për vendimin e marrë në rast të refuzimit të përsëritur të informatës së kërkuar);**

Gjatë vitit 2020 janë parashtruar dy (2) ankesa.

-Ankesa e parë (titulluar si kundërshtim) është parashtruar në GJSRMV më datë 28.02.2020 nga ana e një kërkuar kundër aktvendimit SPI.nr. 5/2020 nga 24.02.2020, me të cilën i është përgjigjur pozitivisht kërkesës së tij për qasje në informatat me karakter publik. Të dhënat e ankesës të kërkuarit nuk janë orientuar drejt përmbajtjes së informatës së pranuar por e konteston aktvendimin për arsye se e njëjta është nënshkruar nga ana e personit zyrtar për ndërmjetësim me informata me karakter publik, në vend të kryetarit të gjykatës. Ankesa është ridërguar për veprim në Agjencinë për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informatat me karakter publik me përgjigje të ankesës dhe shkresat e lëndës. Agjencia me aktvendim 08-70 nga 10.03.2020 e refuzoi ankesën si të pabazë dhe e konfirmoi aktvendimin e GJSRMV.

-Ankesa e dytë është parashtruar në Agjencinë për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informatat me karakter publik për arsye se, për kërkesën për qasje të lirë në informatat me karakter publik kërkuarit nuk i është përgjigjur në afat të paraparë ligjor. Në fakt, duke vepruar për Kërkesën për qasje në informatat me karakter publik, të parashtruar nga ana e kërkuarit më datë 29.10.2020, GJSRMV më datë 26.11.2020 solli aktvendim me të cilin iu përgjigj pozitivisht kërkesës së parashtruar dhe informacionin e kërkuar ia dërgoi kërkuarit më datë 27.11.2020 në formën dhe mënyrën siç ishte theksuar në kërkesë, respektivisht përmes formës elektronike, me ndjesë për vonesën dhe sqarimin se e njëjta është shkaktuar nga puna në kushte të pandemisë me Covid 19. Në të njëjtën ditë, Agjencia me shkresë elektronike ridërgoi ankesën e kërkuarit në GJSRMV. Në datën 03.12.2020 GJSRMV dorëzoi në Agjencinë përgjigje të ankesës dhe shkresat e lëndës. Me aktvendim të Agjencisë nr.08-712 nga data 09.12.2020, procedura për ankesën ndërpritet, për arsye se ankesa konsiderohet si e tërhequr.

## **7. Numri i ankesave të miratuara me vendim të Agjencisë;**

Dy (2) ankesa të miratuara me vendim të Agjencisë. Ka të bëjë me kërkesa për qasje në informata me karakter publik të vitit 2019 të cilave pozitivisht u është përgjigjur, megjithatë kërkuarit nuk kanë qenë të kënaqur nga përgjigja e marrë ashtu që kanë parashtruar ankesa.

-Në rastin e parë Agjencia me aktvendim nr. 08-165 nga data 12.02.2020, e aprovon ankesën e parashtruesit dhe lëndën e tij e kthen përsëri për procedim në GJSRMV, me arsyetim se poseduesi i informatës nuk i ka dorëzuar informatat e kërkuara në tërësi, përkatësisht Përgjigja e kërkesës SPI.nr. 7/2019 nga 15.04.2019 nuk i ka përfshirë të gjitha informatat të cilat i ka kërkuar kërkuarit në pajtim me LQLIKP. Duke vepruar sipas aktvendimit të Agjencisë, GJSRMV solli dhe i dorëzoi kërkuarit Aktvendim SPI.nr. 8/2020 nga 25.02.2020 me të cilën pozitivisht iu përgjigj kërkesës me dhënien e informatës në tërësi, e cila iu dorëzua kërkuarit në formën dhe mënyrën siç ishte theksuar në kërkesë.

Në Agjencinë është dorëzuar njoftim se është zbatuar aktvendimi nr. 08-165 nga 12.02.2020.

-Në rastin e dytë, me aktvendim 08-669 nga 19.02.2020, Agjencia e aprovon ankesën e parashtruesit dhe lëndën e tij e kthen përsëri për procedim në GJSRMV, me arsyetim se poseduesi i informatës nuk i ka dorëzuar informatat e kërkuara kërkuesit përkatësisht Përgjigja e dorëzuar SPI.nr.13/2019 nga 19.07.2019 nuk e përfshin informatën e kërkuar. Duke vepruar për aktvendimin e Agjencisë, GJSRMV solli dhe i dorëzoi kërkuesit Aktvendim SPI.nr. 9/2020 nga 09.03.2020, me të cilën i është përgjigjur pozitivisht me dhënien e informatës në tërësi, në formën dhe mënyrën siç është theksuar në kërkesë. Në Agjencinë është dorëzuar njoftim se është zbatuar aktvendimi nr. 08-669 nga 19.02.2020.

#### **8. Numri i ankesave të ndryshuara të shkallës së parë pas veprimit të Agjencisë;**

Nuk ka vendime të ndryshuara të shkallës së parë pas veprimit të Agjencisë.

#### **9. Numri i ankesave të refuzuara nga Agjencia dhe arsyet për refuzimin e tyre;**

Një (1) ankesë refuzohet me Aktvendim të Agjencisë nr. 08-70 nga 10.03.2020 – e theksuar më lartë nën pikën 6 paragrafi 1 alineja 1. Sipas arsyetimit të aktvendimit, ankesa refuzohet si e pabazë për arsye se Agjencia ka konstatuar se poseduesi i informatave ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 3 paragrafi 1 alineja 5, neni 8 paragrafi 1 dhe paragrafi 3 dhe neni 19 të Ligjit për qasje të lirë në informatat me karakter publik.

#### **10. Numri i ankesave të hedhura poshtë nga Agjencia dhe arsyet për hedhjen poshtë të tyre;**

Nuk ka ankesa të hedhura poshtë nga Agjencia.

Për një ankesë procedura është ndërprerë me aktvendim të Agjencisë nr. 08-712 nga 09.12.2020, për arsye se ankesa konsiderohet si e tërhequr – e lartë theksuara nën pikën 6 paragrafi 1 alineja 2. Arsyeja për ndërprerjen e procedurës është konstatuar nga ana e Agjencisë sepse Kërkuesi e ka pranuar informatën e kërkuar, gjë që është konfirmuar nga ana e tij.

**Shkup, 27.01.2021**

**GJYKATA SUPREME E  
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**

**Person zyrtar për ndërmjetësim  
me informatat me karakter publik  
Mr. Snezhana Dimitrovska**